


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Bulevardi "Zhan D'Ark" Tiranë, Shqipëri Tel/Fax 00 355 04 2260284

Nr. 178 Prot.

Tiranë, më 4.12.2013

URDHËR I BRENDSHËM

"Për balancimin e numrit të çështjeve gjyqësore ndërmjet gjyqtarëve"

Në mbështetje të Ligjit nr. Nr.9877, datë 18.2.2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 18, Vendimit Nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 "Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore", i ndryshuar me vendimin nr. 282.8, datë 16.12.2011, neni 4, pika 3, shkresës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 3305/1 Prot., datë 20.11.2013,

Duke qënë se:

- Me shtimin e organikës dhe numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Tiranë është vënë re një pabarazi në numrin total të çështjeve civile që gjykon secili gjyqtar i dhomës civile;
- Ngarkesa e gjyqtarëve të dhomës civile, të cilët janë emëruar së fundi, rezulton të jetë shumë herë më e vogël sesa ngarkesa e gjyqtarëve të tjerë të dhomës civile;
- Është krijuar një shpërpjesëtim i papranueshëm i ngarkesës së gjyqtarëve, i cili po vë në dyshim transparencën e Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me respektimin e radhës së gjykimit sipas datës së regjistrimit të dosjeve;
- Me qëllim zbatimin e parimit të barazisë së ndarjes së çështjeve sipas nenit 3 të vendimit të KLD nr.238/1/a, datë 24.12.2008 "Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore", i ndryshuar, si dhe balancimin e numrit të çështjeve gjyqësore ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të dhomës civile të Gjykatës së Apelit Tiranë;

URDHËROJ:

1. Mospjesëmarrjen e përkohshme në short, të gjyqtarëve sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri, për çështjet civile të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë.

2. Mospjesëmarrja në short, e këtyre gjyqtarëve është e përkohshme, derisa të balancohet numri i dosjeve ndërmjet të gjithë gjyqtarëve të kësaj gjykate.

3. Ngarkohet Kryesekretarja Zj. Flora Shakaj dhe Specialistja e IT zj. Elvira Pitarka të marrin masat përkatëse për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ky urdhër të afishohet në Sallën e pritjes së publikut si dhe në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ALAUDIN MALAJ

